



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gjilan
Gilan Belediyesi

Në pajtim me nenin 12 paragrafi 12.1 shkronja d), nenin 17 shkronja o) të ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, në nenin 37 paragrafi 1.15, nenin 38 paragrafi 1.4 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01.nr.016-126211te datës 06.11.2014 si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale 01.nr.66/2015 të datës 07.07.2015 dhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa 01.nr.68/2015 të datës 20.07.2015, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur me datë 30.07.2015 miratoi këtë:

V E N D I M

PËR EMËRTIMIN E QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE NË GJILAN

1. Me këtë vendim emërtohet Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Gjilan me emrin : **QKMF "Dr.Nagip Rexhepi"**.
2. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i komunës dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ndërsa për monitorim te zbatimit kujdeset Kryesuesja e KK-Gjilan
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare ne ueb faqen e Komunës

01. Nr. 016-73810
Gjilan, më 30.07.2015

Kryesuesja e Kuvendit

/Valentina Bunjaku-Rexhepi/